

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.07.12.2024*

**07.12.2024
Ora, 11:06**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• Komisioni Rregullator:

- | | | |
|------------|-------|---|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | J. Josifi, P. Doçaj, D.Alimemeti, B.Kodra |

Parti Politike: PL (K. Kolndreu)

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.07.12.2024*

politike, përfaqësues të shoqërisë civile dhe media. Në mbledhjen e ditë së sotme kemi tre çështje për shqyrtim. Së pari,

- Projektvendimi “Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabulimin e rezultatit të votimit nga jashtë”.

- Akti i dytë, projektvendimi “Për caktimi e kufijve dhe ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor, për Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”.

- Projektvendimi i tretë, “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore, për Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”.

Para se të fillojmë me shqyrtimin e akteve sipas rendit të ditës, do të pyesja kolegët, nëse kanë diçka jashtë rendit të ditës, apo diçka paraprakisht për të diskutuar!? Zoti Çakaj, po!

Z. M. Çakaj: Faleminderit zonja Kryetare! Unë kisha diçka në lidhje me rendin e ditës, me çështjen e parë të rendit të ditës. Në lidhje me projektaktin “Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabulimin e rezultatit të votimit nga jashtë”. Unë e kam lexuar me vëmendje projektaktin dhe kam disa pyetje për administratën. Ky projektakt është propozuar zyrtarisht nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në datën 12 nëntor 2024. Siç dihet, referuar Kodit Zgjedhor, afati ligjor për miratimin e këtyre projektakteve ishte jo më vonë se 90 ditë, nga data e hyrjes në fuqi. Nga data e publikimit të ndryshimeve ligjore të datës 26 korrik, pra ndryshimet e Kodit Zgjedhor ku përfshihej për herë të parë dhe ku u rregulluan dhe procedurat e votimit për emigrantët dhe ky afat 90 ditor përfundonte në datën 13 nëntor. Pra, një ditë përpara se të përfundonte afati, na është propozuar për njohje ky projektakt. Ndërkohë që propozimi për miratim, për të qenë korrekt me të gjitha palët është tej

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.07.12.2024*

afatit 90 ditor. Pra, jemi në shkelje të afatit të Kodit Zgjedhor, së pari. Së dyti, në relacionin bashkëlidhur këtij projektakti, na është bërë me dije, si dhe në komunikimet që kemi pasur disa herë me administratën dhe Komisionerin, se është kërkuar mendim. Ky projektakt është dërguar pranë shoqërisë civile, pranë partive politike për të dhënë mendime. Ndërkohë, ditën e pardjeshme, në mos gaboj, në datën 5 na është propozuar zyrtarisht ky projektakt për shqyrtim dhe miratim. Nuk kemi gjetur, sigurisht ndryshonte nga projektakti i parë, por nuk kemi gjetur asnjë mendim me shkrim, as në relacion të shprehur, por as ndonjë mendim paraprak me shkrim, qoftë nga shoqëria civile, përveç Organizatës KRIIK, qoftë nga partitë politike. Nuk e kemi gjetur as të reflektuar në relacion. Unë kam disa pyetje paraprake për administratën. Së pari, përpara se të kalojmë në shqyrtimin e projektaktit, referuar mënyrës se si është propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për numërimin e votave. Në projektaktin që keni sjellë paraprakisht për njohje dhe vlerësim, ju kishit parashikuar që grupi i numërimit të votave, do të mbikqyrej, ose do të vëzhgohej në procesin e vetnumërimit nga përfaqësuesit/vëzhguesit e partive politike. Në këtë projektakt e keni hequr. Së pari, çfarë mendimi kanë partitë politike për këtë ndryshim? Keni ndonjë përgjigje? Së dyti, Komisioni i Administrimit të Votave që është organi epror i grupit të numërimit të votave është propozuar nga tre përfaqësues, ose administratë e KQZ-së. Po këtu, a keni menduar ose keni diskutuar me partitë politike? A kanë nevojë për vëzhgues, anëtarë pa të drejtë vote të partive politike të këtij komisioni, në mënyrë që burimin e informacionit ta marrin në mënyrë të drejtë për drejtë? Sigurisht që në kuadër të transparencës të kenë informacion dhe akses të drejtë për drejtë në procesin e administrimit të gjithë numërimit të votave të shqiptarëve me banim jashtë vendit.

Znj. I. Nano: Po zonja Vukaj!


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.07.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Në vijim të çështjes që ngriti kolegu Çakaj, i bashkëngjitem për sa ka konstatuar e në të njejtën kohë do të doja të theksoja sërish me shqetësim që edhe pse aktet janë kaq të rëndësishme, përsëri nuk gjejmë në këtë tryezë propozuesin konkret, Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Këtë herë pa asnjë argument të përligjur, sepse po të ishte i tillë, Komisioneri nuk do të gjendej poshtë në zyrën e tij, apo do të kishim një autorizim specifik, i lihet kjo ngarkesë administratës. Ndërkohë që administrata është thjesht dhe vetëm një draftuese teknike. Për sa i përket aktit që ngriti për diskutim kolegu Çakaj është një akt i cili jo vetëm gjendet në kapërcim të afateve dhe nuk e di impaktin që do të sjellë kjo, por nga ana tjetër edhe pse disi është justifikuar Komisioneri duke thënë që në datën 12 nëntor projektvendimin “Për rregullat, numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabulimin e rezultatit të votimit nga jashtë”, ua ka çuar për konsultim publik nëpërmjet email-it Komisionit Rregullator, përfaqësuesve të partive politike dhe organizatave të tjera të diasporës dhe shoqërisë civile vendase dhe të angazhuara në mirëqenien e demokratizimit. Thotë “i kam vënë në dispozicion një afat 15 nëntor, ora 16:00”. Mua më lind pyetja këtu, çfarë u bë pas këtij afati? Një! Cilat janë opinionet e dërguara nga këto organizata, apo nga partitë politike të cilat mund edhe të justifikojnë kohën në qoftë se ato janë reflektuar. Përse u mbajt përtej datës 15 nëntor dhe na vjen pothuajse tre javë më pas në fillim të dhjetorit? Përse ka ardhur sërish në atë cilësi që nuk duhet të ishte në qoftë se do të kishte reflektim? Së pari, te “Parimet e Përgjithshme”, te standardet të cilat nuk duhet të ishin një dhe dy, sepse është një nga aktet më të rëndësishme, ajo e integritetit, sigurimit të votës, e leximit të saj. pra, nuk do të ishte e vakët, ose e pakët, por do të ishte e shtuar, e konsoliduar. Unë këtë nuk e gjej, të nderuar! Përpos kësaj, unë do të doja të kisha në tryezën time, pa diskutim opinionet e dorëzuara me rastin e këtij konsultimi, që të vlerësoj se cilat

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.07.12.2024*

janë ato dhe sa i keni respektuar në të njejtën kohë. Kaq për këtë akt, për aktet e tjera më pas do të doja.., ose po e shpreh që tani. Aktet e tjera kërkojnë pa diskutim atë që e kemi thënë në çdo mbledhje. Kërkojnë referimin dhe shpjegimin e tyre me një skicë, me një hartë, me një organizim tjetër digjital, me qëllim që të kuptohet edhe nga publiku se çfarë jemi duke bërë dhe se sa po i respektojmë kriteret ligjore. Kështu që merrni masa që për dy aktet e tjera të kemi në paraqitje grafike, ose në monitor hartën respektive, me qëllim që të verifikojmë të gjitha kriteret, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Meqenëse edhe kolegët bënë disa pyetje në lidhje me aktin e parë atë të rregullave të numërimit, meqenëse nuk kemi filluar shqyrtimin, janë disa momente që unë vlerësoj se ka një mungesë të një hallke procedurale të paktën, sepse e lidh këtë me aktin për votimin të miratuar më herët nga Komisioni Rregullator. Sipas aktit që kemi në duar për të shqyrtuar, me mbylljen e orarit të votimit, të gjitha kutitë që ndodhen në vendin e posaçëm qoftë kutia e votimit, qoftë kutia e posaçme. Kutitë e votimit, kutitë e posaçme dhe kutitë rezervë janë në vendin e posaçëm. Ato do të transferohen në vendin e numërimit të votave. Të mos harrojmë që kutia rezervë është planifikuar, është parashikuar nga ne në këtë akt, për të pritur dokumentacion zgjedhor që vjen në KQZ pas orës 19. Ky dokumentacion ndahet pastaj në dy kategori, që ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë para orën 19 dhe që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë pas orës 19. Por të gjitha do të vijnë në KQZ, në ambjentin tonë cilido qoftë ai ambjent pas orës 19. Mua më mungon në këtë akt se çfarë ndodh me këtë gjë. Pra, akti thotë “numërohet kutia e votimit, numërohet kutia e posaçme, numërohet kutia rezervë”. Ndërkohë kutia rezervë ka ardhur bosh nga vendi i posaçëm, sepse aty do të hynte dokumentacioni zgjedhor, vota le të themi, që vijnë në KQZ pas orës 19, pavarësisht

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.07.12.2024*

dy grupimeve. Pra, mua kjo më mungon dhe do të doja të dija si e keni menduar këtë proces? Po zoti Çaka!

Z. D. Çaka: Faleminderit, përshëndetje! Do të doja të bëja një ndërhyrje për procedurë më shumë. Duke qenë se para shqyrtimit të këtij akti, pra para rendit të ditës, pati pyetje nga kolegët, të cilat me sa shoh kërkojnë dhe një investim të administratës në lidhje me një dokumentacion të kërkuar, siç është dhe kërkesa e koleges Vukaj për opinionet e dhëna nga partitë politike, organizatat, shoqatat. Duke qenë se dhe Kryetaria shtoi një procedurë që në vlerësimin e saj është e munguar në projektvendimin e sjellë. Duke qenë se rendi i ditës ka dhe dy pika të tjera, dy projektvendime të cilat njëri prej tyre është dhe me afat më determinues siç është ajo e përcaktimit të kufijëve të zonave zgjedhore. Unë do të kisha një propozim, në qoftë se do të gjeja dhe mirëkuptimin e kolegëve që, kjo pikë e rendit të ditës të hiqej. Pra, shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë”. Në mënyrë të tillë që në seancën tjetër të mos kemi më shtyrje dhe vazhdimësi siç kemi pas dhe me akte të tjera, por të kemi një kuadër të plotë, jo vetëm të përgjigjeve të pyetjeve të kolegëve, por mbase dhe në një rishikim të proceseve munguese në qoftë se ekzistojnë edhe pas konstatimit të zonjës Nano. Mbase dhe administrata në këtë periudhë do të shqyrtonte më në detaje aktin për ndonjë mangësi të mundëshme, do të na vinte në dispozicion edhe dokumentacionin e kërkuar dhe përgjigjet e pyetjeve. Në seancën që do të caktohet përsëri në rendin e ditës të kemi një kuadër të plotë si dokumentar por dhe ligjor për ta shqyrtuar. Duke qenë se ky është në vlerësimin tim, akti përmbyllës i një procesi që filloi me aktin “Për regjistrimin e votuesve nga jashtë...”, ky do të jetë akti përfundimtar për sa i përket procedurave të votimit. Kështu që propozoj që ky

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.07.12.2024*

projektvendim të hiqet nga rendi i ditës për t'u shqyrtuar në një seancë tjetër, faleminderit!

Znj. I. Nano: Po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në kuadër dhe në vazhden e propozimit që bëri kolegu, personalisht e gjej me vend, sepse akti siç e shihni, ka shumë boshllëqe dhe mangësi. Në të njejtën kohë një kërkesë që i shtoj administratës është, a keni marrë dakordësi politike për ambjente të tjera që do të shfrytëzohen, sepse Kodi për këtë rast, për votimin nga jashtë, përcakton që ambjenti i vetëm është ai i KQZ-së. Kështu që a kemi dakordësi politike dhe nëse po, një referencë, ose një shkresë, apo një opinion të tyre.

Znj. I. Nano: Atëherë, ne drejtuam disa pyetje dhe disa kërkesa për dokumentacion administratës, do t'i lemë një kohë që e gjykojmë ne, bashkë me këta, të arësyeshme dhe më tej votojmë heqjen nga rendi i ditës, për këto çështje që u ngritën për diskutim pyetje dhe kërkesa. Mund të na thoni, kur është e përshtatshme, dimë që dhe e hëna është pushim. Një afat pesë ditor do të ishte i mjaftueshëm për ..? Po zonja Josifi!

Znj. J. Josifi: Mirëmëngjes, faleminderit për fjalën! Me daljen e Dekretit të Presidentit, ne jemi në punë si administratë dhe ditët e shtuna dhe ditët e festave zyrtare. Me këtë rast edhe ditën e hënë, pjesa më e madhe e administratës është në punë, nëse ju na vendosni këtë afatin maksimal pesë ditor, ne do të përpiqemi të përgjigjemi brenda kohës në dispozicion.

Znj. I. Nano: Atëhere brenda pesë ditëve për të pasur përgjigje, faleminderit! Atëherë kolegë hedhim në votë ndryshimin e rendit të ditës të propozuar nga zoti

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.07.12.2024*

Çaka pra, heqjen e këtij projektvendimi nga rendi i ditës dhe të vijojmë me dy të tjerat.

Kush është dakord?

***Pro:** 5 (zgj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)*

***Kundër:** s'ka!*

Me 5 vota pro ndryshon rendi i ditës!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

07.12.2024
Ora, 11:22

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për caktimin e kufijve dhe ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor, për Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**


- | | | |
|------------|-------|---|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | J. Josifi, P. Doçaj, D.Alimemeti, B.Kodra |

Parti Politike: PL (K. Kolndreu)

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Vazhdojmë me dy projektvendimet e tjera, së pari me projektvendimin “Për caktimin e kufijve dhe ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor, për Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”. Do fillojmë me relatimin kolegë dhe më pas nëse ka pyetje. Po zonja Doçaj!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. P. Doçaj: Përshëndetje! Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës që ka ta bëjë me caktimin e kufijve dhe ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor, për Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025, relacionin e paraqitur përpara jush e kemi të ndarë në dy seksione. Fillimisht kemi një vlerësim të ligjshmërisë, bazës ligjore ku jemi bazuar për përpilimin e këtij projektvendimi. Në nenin 20, pika 2, shkronja “a” parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet për kufijtë e zonave të administrimit zgjedhor. Në nenin 27 dhe 28 jemi bazuar pikërisht për të përcaktuar kriteret ligjore për ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor. Për sa i përket seksionit të dytë kemi menduar që të bëjmë një përmbledhje shpjeguese të këtij projektvendimi. Sipas nenit 27, jo më vonë se 10 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon të dhënat KQZ-së, të ndara sipas njësive të qeverisjes vendore, numrin e shtetasve me të drejtë vote. I jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në datën 18.11.2024. Në datën 3.11.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile na ka dërguar gjithë informacionin nëpërmjet komunikimit elektronik. Referuar këtij komunikimi dhe zbatimit të nenit 27 të Kodit Zgjedhor, nga ana jonë janë kryer përllogaritjet e mëposhtëme.

Nga 61 bashki rezulton se:

- 50 bashki kanë më pak se 80 mijë zgjedhës, ashtu siç kanë qenë dhe zgjedhjet e kaluara e nuk lind nevoja për ndryshimin e tyre.
- Në 11 bashki rezulton se kanë më shumë se 80 mijë zgjedhës dhe janë të ndara në dy ZAZ. Nga këto 11 bashki vetëm për dy lind nevoja që të kemi ndryshime. Në ZAZ me numër 21 në Bashkinë e Durrësit dhe ajo me numër 29 në Bashkinë e Tiranës. Të dyja janë zona rurale, dhe kanë më shumë se 80 mijë zgjedhës. Në ZAZ nr. 21 në Bashkinë e Durrësit ka 83.168 zgjedhës dhe në ZAZ nr. 29 në Bashkinë e Tiranës ka 82.631 zgjedhës. Për të ruajtur vazhdimësinë e territorit dhe numërin e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

përafërt të zgjedhësve, propozohet që ZAZ me numër 21 në Bashkinë e Durrësit, të ndahet në dy zona të cilat i keni të përcaktuara në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij akti. Konkretisht, njësitë administrative Ishëm, Sukth e Manëz të përfshihen në një ZAZ dhe njësitë administrative Rashbull e Katund i ri në një tjetër ZAZ. Në Bashkinë Tiranë është menduar të mos ndahet ZAZ nr. 29, por thjesht të lëvizet nga kjo ZAZ njësitë administrative Petrelë që ka 5460 zgjedhës e të kalojë në ZAZ-në vijuese që ka nr. 30 dhe ka 69 026 zgjedhës. Kjo zgjedhje është bërë në mënyrë që të ruhet kriteri i vazhdimësisë së territorit, numëri i përafërt i zgjedhësve dhe të shmanget shtimi i një ZAZ-je tjetër që do të jetë më e vështirë dhe për administrimin e të gjithë ZAZ-ve. Për sa më lart u relatua dhe në respektim të detyrimeve që na lindin nga ligji, ju propozojme për shqyrtim dhe miratimin tuaj projektvendimin “Për caktimin e kufijve dhe ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor”.


Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Doçaj!

Znj. P. Doçaj: Me falni, do të duhet të saktësojmë dhe diçka. Projektvendimi ju është vënë në dispozicion para caktimit të datës së zgjedhjeve nga Presidenti dhe nuk ka të saktësuar datën e zgjedhjeve pra, “...të zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

Znj. I. Nano: Kur ta shqyrtojmë e propozojmë dhe këtë ndryshim. Dakord, faleminderit! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Përpara se ta shqyrtojmë, unë kam një mori me pyetje për zonjën ndoshta Doçaj, ndoshta kush është kompetentia... dakord, të dy koleget. Së pari, hartën bashkëlidhur nuk e gjetëm në këtë projektakt. Natyrshëm lind pyetja, si do ta

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

bëjmë vlerësimin e projektaktit, kur minimalisht duhet një hartë bashkëlidhur. Dakord, ne po themi që po i vijmë vërdallë dhe po pyesim, po i referohemi aktit të vjetër e kështu me rradhë. Po publiku si do ta kuptojë? Sot që të kalojë ky akti, duhet bërë kalimi zë për zë i ZAZ-ve, ku do të verifikohet pandashmëria, vazhdimësia, kompaktësia, mundësi të mira komunikimi, numër i përafërt zgjedhësish dhe të tjera nënkritere që vijnë brenda këtyre kritereve. Më thoni ju, si ta bëjmë vlerësimin sot?

Znj. P. Doçaj: Duke qenë se nga ana jonë, nga drejtoria përkatëse është kryer një vlerësim i tillë, është kryer vlerësimi...

Znj. H. Vukaj: Nuk më duhet! Ju jeni te pjesa e draftaktit e dashur, sot kalohet akti, nëse do kalohet!

Znj. P. Doçaj: Si administratë ne kemi shqyrtuar me drejtorinë kompetente teknikisht dhe nga pikëpamja e ligjshmërisë. Pra, nga propozimi që ju kemi bërë, mendojmë se është në përputhje me nenin 27, 28 e vijues, për sa i përket pjesës së ligjshmërisë janë ruajtur përcaktimet e të dyja neneve, për sa i përket juridiksionit territorial e të tjera...

Znj. H. Vukaj: Mund të më thuash cila është drejtoria kompetente që e ka verifikuar, sepse ju keni verifikuar vetëm ligjshmërinë?

Znj. P. Doçaj: Po, këtë doja të thoja. Duke qenë se e kemi hartuar, kemi qenë në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse, e cila ka kryer edhe verifikimin teknik dhe ndarjen e zonave të administrimit zgjedhor. Duke ndjekur dhe njëherë nga pikëpamja

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

teknike dhe ligjore të njejtat kritere që janë ndjekur dhe në vitet e shkuara. Është menduar, pra i vetmi ndryshim që ndodh në këtë akt është pikërisht ndarja e ...

Znj. H. Vukaj: Çdo akt vjen për së pari, që do të thotë që verifikimi i ligjshmërisë bëhet nga “a” te “zh”, për së pari në draftin e ardhur...

Znj. P. Doçaj: Siç është bërë, është verifikuar.

Znj. H. Vukaj: Cila është drejtoria përkatëse që ka në kompetencë këtë ndarje, sepse ju keni parë dhe verifikuar ligjshmërinë që mua personalisht, apriori, nuk po i hyjmë aktit, më rezulton që ka...

Znj. P. Doçaj: Mangësi!

Znj. H. Vukaj: Po sigurisht! Sapo parashtruat...

Znj. P. Doçaj: Do t’i pasqyrojmë, në rast se ka mangësi.

Znj. H. Vukaj: Më e duruar zonjë!

Znj. I. Nano: Kemi dy drejtori dhe dy drejtoresha këtu. Kemi drejtoreshën e ligjshmërisë dhe tjetra është drejtoresha e ...

Znj. H. Vukaj: Po, po e kam të qartë...

Znj. I. Nano: Kështu që t’i drejtojmë pyetje secilës...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Meqenëse zonja Doçaj mori përsipër që të fliste, ndaj ju drejtova asaj, që të dimë, cila është drejtoria respektive që të na thotë, a janë respektuar kriteret për secilën? Kemi një shkresë ku merrni përsipër, një relacion tuajin përtej kësaj. Ky është një relacion në fund të ditës, i Komisionerit, pra i propozuesit. Po janë verifikuar! Unë e dua bashkëlidhur atë, që janë verifikuar kriteret për secilën nga ZAZ-të dhe për propozimet. Nuk më rezulton që i njejtë kriter dhe pa shpjegim këtu në fakt në draft i Petrelës të jetë ndjekur për Durrësin ose të kemi një lloj barazvlerësimi sipas kritereve që përcakton neni 27. Hartën së pari, mua dhe kolegëve dhe atje në monitor hartën që të kuptojnë të gjithë shikuesit dhe ata që na ndjekin.

Znj. I. Nano: Pra, nëse e kemi hartën le ta prezantojmë në monitor.

Z. M. Çakaj: Kisha dhe unë diçka! Atëhere, unë e dëgjova me vëmendje relacionin tuaj. Së pari, me keqardhje konstatoj që gjithë vërejtjet që kemi bërë në mbledhjet e tjera publike, nuk janë reflektuar. Këtu shoh një relacion dhe një projektvendim të propozuar nga Drejtoria e Logjistikës me drejtore Daniela Alimemeti, Drejtoria e Ligjshmërisë me drejtore pavlina Doçaj dhe Sekretaria e Përgjithshme Majlinda Çelmeta. Minimalisht për korrektesë institucionale do të duhej firma, meqenëse ju e propozoni. Së dyti, ju relatuat që keni komunikuar në datën 18 nëntor me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe keni marrë përgjigje në datën 3 dhjetor me email, por në propozim nuk e gjejmë as me shkresën tuaj, as përgjigjen. Së treti, do të duhej të na vihej dhe të merrej në analogji zonat zgjedhore të miratuara po nga ky komision në vitin 2021. Çfarë do të doja unë personalisht të kishim në relacion? Çfarë ndryshimesh ka? Çfarë risish, shtesash, ose çfarë nuk ndryshon? Së katërti, ju aty në tavolinën tuaj tani unë po shoh që i keni ato hartat. Po ne pse nuk i kemi

*Zbardhi materialin audio
Merița DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

hartat? Tani kjo nuk është korrekte. Nuk zhvillohen kështu mbledhjet! Tani, ose do të jemi në të njëjtat pozita... ju keni dhe informacionin, shkresën drejtuar..., komunikimin, koorespondencën me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, keni hartat, keni gjithë informacionin e mundshëm, ndërsa ne kemi vetëm draftin dhe e miratoni! Kjo nuk është korrekt! Më vjen shumë keq!


Znj. H. Vukaj: Mund të vijoj të lutem se kolegu ndërhyri dhe meqenëse u sinkronizua, ishte në rregull. Më rezulton që ju përmendët që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është në afat? I keni matur mirë afatet se nuk më rezulton të jetë në afat. 10 muaj i thonë në datën 10.11.2024 dhe jo në datën 3.12,2024. Ka ndonjë efekt kjo, apo si mund ta lexojmë këtë? Pra, përgjigjen me vonesë të DPGjC? A jep impakt kjo? Përse duhet të vononte DPGjC e cila tani është një institucion i pabesueshëm, po t'i referohemi auditimeve të bëra ndaj të dhënave që sjell ajo. Ka ndonjë prapavijë kjo?

Znj. I. Nano: Ta nisim me zonjën Alimemeti lidhur me hartën që kërkuan kolegët dhe nëse është e mundur një kopje ta kemi dhe këtu. Në çdo rast duhet të jetë pjesë e praktikës të projektvendimit. Pra, nëse ne sot e miratojmë, kjo duhet të jetë bashkëlidhur. Lidhur me pyetjet, e para...

Z. M. Çakaj: Lidhur me ndryshimet, Durrësi dhe Tirana. Ju keni propozuar dy ndryshime, apo jo, mos gaboj? Të paktën hartën për këto dy...

Znj. I. Nano: Me sa shoh atje është për Durrësin dhe Tiranën.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Z. M. Çakaj: Duhet të shohim verifikimin, ju e keni parë, patjetër nuk e diskutoj këtë gjë, por ta shohim edhe ne meqenëse do ta miratojmë, verifikimin e kushteve të nenit 27 dhe 28 të Kodit Zgjedhor.

Znj. D. Alimemeti: Janë të paraqitura të dyja hartat e qarkut, duke qenë se qarku duket dhe i jep një pamje më të qartë të zhvendosjes që ne kemi menduar të bëjmë. Një nga pyetjet që ju kishit është se pse është mbajtur një standard për Durrësin dhe një tjetër standard për Tiranën...

Znj. H. Vukaj: Sepse në aktin dhe në relacion nuk ka asnjë shpjegim që të thuhet që “ne ndoqëm këtë standard për Tiranën, për Durrësin dhe këtë standard për Petrelën, sepse kanë këto kritere të cilat nuk përshtaten me njëra tjetrën së paku. Por para se të vazhdosh, Daniela, mua më duhet tani për vijimin e aktit, shkresa e DPGjC.

Znj. D. Alimemeti: Patjetër!

Znj. H. Vukaj: Rezulton se është jashtë afatit. Si i doli brenda afatit zonjës Doçaj? Si merr përsipër Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të thotë “reflektojmë shtetasit me të drejtë vote deri në datë 15 maj 2025..”.

Znj. I. Nano: Është fundi i ...

Znj. H. Vukaj: Më lini të mbaroj pyetjen. Ka dekadencë, nëse vdesin njerëz, ka ndryshime në këtë pjesë, apo jo? Jo këtë pyetje ta kishit ju sqimatarët, t’ia kërkonit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

drejtorisë së përgjithshme... pikërisht pra, ndaj ajo duhet të thotë që informacioni është deri në këtë datë, jo të parashikojë datën 2025. Pavarësisht se e dikton kodi, sepse do të silllet përsëri informacion për hir të listave.

Znj. D. Alimemeti: Po patjetër në vazhdimësi do të sjellë...

Znj. H. Vukaj: Po, pra këto detajet i dijmë, por për saktësi, ju nuk do të lini gjë t'u shpëtojë në respekt...

Znj. P. Doçaj: Kanë marrë përsipër të deklarojnë që ajo listë është e atyre zgjedhjeve pra, të majit 2025. Është e përcaktuar në kod dhe mendoj se nuk është ndonjë detaj që i vlen, i shërben, apo...


Znj. H. Vukaj: A janë emëruar auditët për të filluar proceset e verifikimit, në dijeninë tuaj?

Znj. D. Alimemeti: Jo ende, do të fillojë procesi tani me shpalljen e dekretit dhe është një afat pesë ditor që bëhet emërimi i auditëve teknikienë. Në vijim doja t'ju sqaroja se folëm për Durrësin...

Z. M. Çakaj: Ideja është se duhet ta shpjegojmë, edhe për Komisionin Rregullator, por edhe për publikun, për të gjithë ata që janë në interesuar, të shohim dy ndryshimet për Durrësin dhe Tiranën. Njësia Petrelë se ku shkon.

Znj. D. Alimemeti: Zona 21 është e gjithë kjo zona. E gjitha është zonë rurale është menduar ndarja, sepse nuk kemi mundësinë e bashkimit të një zone rurale me një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

zonë të qytetit, ndryshe nga sa u bë në Tiranë që një zonë e morëm dhe e vendosëm në.., Petrelen e vendosëm në një zonë tjetër ZAZ tjetër e cila është përsëri rurale. Këtu nuk e kishim këtë mundësi. Alternativa që ne shfaqëm...

Znj. H. Vukaj: Pse nuk e kishit atë mundësi? Na i shpjegoni tani bashkë me drejtoreshën juridike.

Znj. D. Alimemeti: Ideja është... ZAZ nr. 21 ka më shumë se 80 000 zgjedhës dhe i ka të ndarë në Manëz, Sukth, Ishëm dhe Katund i Ri. Ne propozojmë që kjo të ndahet në dy zona, kjo pjesë. Pjesa tjetër nuk ofron dot që një pjesë psh Ishmin ta bësh me.., ose një zonë tjetër ta bashkosh me Durrësin...

Z. M. Çakaj: Daniela, të ta bëjmë më të thjeshtë të lutem, ke dhe hartën aty. Merr një shkop ose një stilolaps dhe na trego, ku është Sukthi, ku është Katundi i Ri, ku është Manza, ku është Ishmi? Bëje me kriter gjeografik. Kë keni propozuar ju të ndani?

Znj. D. Alimemeti: Kemi propozuar të ndajmë Ishmin dhe...

Znj. H. Vukaj: Zonja Doçaj, e ka ligji kriterin urban dhe rural, se mua nuk më rezulton?

Znj. P. Doçaj: Në nenin 27, pika 2 përcaktohet se si duhet të jetë juridiksioni territorial i ZAZ-ve, si rregull, është i njëjtë me territorin administrativ të bashkisë, sipas ligjit që rregullon organizimin administrativ-territorial të Republikës së Shqipërisë. Bashkitë që kanë më shumë se 80 000 shtetas me të drejtë vote ndahen

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

nga KQZ-ja në më shumë se sa një Zonë të Administrimit Zgjedhor, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

- a) pandashmëria e territorit të njësisë administrative, përjashtuar ato me më shumë se 80 000 zgjedhës;
- b) vazhdimësia dhe kompaktësia e territorit, duke shmangur barrierat gjeografike;
- c) mundësi të mira komunikimi brenda territorit;
- ç) numër i përafërt zgjedhësish. Ligji në këtë rast...

Znj. H. Vukaj: Nuk është nevoja të më lexosh ligjin, se e kam përpara. Të pyeta konkretisht. Ligji të përcakton që një zonë rurale nuk mund ta bashkosh me një zonë urbane? Apo ka kriteret?

Znj. P. Doçaj: Është ndjekur tradita si gjithmonë, që një zonë rurale bashkëngjitet me një zonë rurale, spostohet në një zonë rurale.

Znj. H. Vukaj: Tradita është kriter i ligjit në këtë rast?


Znj. P. Doçaj: Tradita është kriter i traditës dhe ndjek...

Znj. H. Vukaj: Tradita është kriter i traditës?! Është e fundit në burime njerëzore.., në burime ligjore, tradita, në dijeninë e një juristi, ose praktikant e mira...

Znj. P. Doçaj: Për deri sa është ndjekur në vazhdimësi edhe nga ky komision është miratuar para katër vitesh në vitin 2021 identik me të njëjtin arësytim...

Znj. H. Vukaj: Prandaj akti është i cunguar dhe nuk ka të paktën të njëjtin draft...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. P. Doçaj: Akti mund të jetë i cunguar dhe ne do të pasqyrojmë çfarëdolloj propozimi që ju bëni. Arësytimi ligjor është neni 27, pika 2...

Znj. H. Vukaj: Më kaloni të gjitha kriteret, për të gjitha propozimet...

Znj. P. Doçaj: Kriteret sapo i lexova dhe...

Znj. H. Vukaj: Jo, jo mi kalo në linjë krahasimore me të gjithë propozimin tuaj, që unë të bindem që janë në rregull.

Znj. P. Doçaj: Atë pjesë e bën drejtoresha...

Znj. H. Vukaj: Kriteret ligjore, drejtoresha...

Znj. P. Doçaj: Kriteret sapo i lexova.

Znj. H. Vukaj: Ato i ka kodi, unë i lexoj...

Znj. P. Doçaj: Këto ka ligji, po do të përpiqem...

Znj. H. Vukaj: Dhe ligji në këtë draft të ... do të doja që secili kriter të spontohej...

Znj. P. Doçaj: Nëse keni ndonjë mendim tjetër, ne mund ta ndajmë dhe t'i zëvendësojmë në një formë tjetër.

Znj. H. Vukaj: Për mua nuk ka argument, argument në relacion nuk ka.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. P. Doçaj: Argumenti ligjor është neni 27, pika 2...

Znj. H. Vukaj: Nuk është argument, është referencë.

Znj. I. Nano: Një moment zonja Doçaj ndjesë, një moment.

Znj. H. Vukaj: Kështu që së bashku me Danielën do të doja që të kalonit zë për zë secilat kritere për këtë ndarje.

Znj. I. Nano: Atëhere, për ndarjen sigurisht që kriteri qëndron se janë mbi 80 000, për bashkimin me njësi tjetër le të na thonë argumentin. Për ndarjen e kemi argumentin ligjor mbi 80 000..., e kemi argumentin ligjor. Për bashkimin...

Znj. H. Vukaj: Ajo duhet të kalojë të gjitha kriteret një për një.

Z. M. Çakaj: Po! Ajo çfarë po presim të na thotë drejtoresha është, këtu në relacion është parashikuar për të ruajtur ekzaktësisht këtë gjë. Pra, kriterin gjeografik, për të ruajtur vazhdimësinë dhe kompaktësinë e territorit, na e pasqyro aty, të lutem! Kaq dhe jemi të gjithë të qartë! Ne jemi të qartë, do të donim vetëm hartën, sigurisht për korrektesë institucionale, do të donim dhe korespondencën, por në rastin konkret, të qartë për publikun për të ruajtur vazhdimësinë dhe kompaktësinë e territorit, pra kriteri gjeografik është ruajtur. Na e trego!

Znj. I. Nano: Cila është ZAZ nr. 21 sot?

Z. M. Çakaj: Ishëm, Sukth dhe Manzë e ta shohim të gjithë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. I. Nano: Pra, si ka qenë dhe si bëhet ZAZ nr. 21 në hartë.

Znj. D. Alimemeti: Aktualisht harta që kemi është harta e zgjedhjeve të 2023 dhe përcakton ZAZ nr. 21 në gjendjen siç ka qenë, por mund të kemi një...

Z. M. Çakaj: Si e keni propozuar?

Znj. D. Alimemeti: Kemi propozuar Ishëm dhe Manzë në një zonë dhe Sukth e Katund i Ri në një zonë. Duken të ndara dhe qartësisht të përcaktuara sipas kriterit... Plotësohet dhe kriteri i numërit dhe pjesa gjeografike.


Z. M. Çakaj: Për korrektesë, keni propozuar në Bashkinë Durrës njësitë administrative Ishëm, Sukth dhe Manzë të përfshihen në një ZAZ dhe Rrashbull, Katund i Ri në një ZAZ tjetër. Pra ato të treja sipër në një ZAZ dhe këto dy poshtë në një ZAZ tjetër. Kriteri gjeografik për të ruajtur vazhdimësinë dhe kompaktësinë e territorit faleminderit, qartë!

Znj. I. Nano: Pyetje tjetër, nëse duhet Daniela të qëndrojë?

Znj. H. Vukaj: Për mua, duhet të vazhdojnë të gjitha kriteret aty, të spontuara, që janë plotësuar që të gjitha. Sepse, në qoftë se marrim për argument mbi 80 000 banorë, atëherë, pse te Petrela, e merrni Petrelën dhe e çoni në Zallbistar, Zallherr dhe e bashkoni me një ZAZ që s'ka lidhje gjeografike?

Znj. D. Alimemeti: Ka lidhje gjeografike...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. H. Vukaj: E keni idenë se ku i bie...

Znj. D. Alimemeti: Do ta shihni në hartë, ju lutem.

Znj. I. Nano: Daniela, mbarojmë me këtë një herë, pastaj kalojmë te Tirana.

Znj. D. Alimemeti: Mendoj t'ju tregoj dhe Tiranën dhe të shihni që është vërtet ajo që ju keni... ai është propozim në fund të ditës dhe është një mënyrë se si e kemi menduar ne për të zgjedhur ndarjen, ose për të reduktuar një ndarje, një shtesë.

Znj. H. Vukaj: Pse nuk propozuat që një pjesë të ZAZ nr. 21 ta kalonim te ZAZ nr. 22?

Znj. D. Alimemeti: ZAZ nr. 22 e kemi këtu dhe është në Qarkun Durrës, këtë po përpiqem të them. Bashkimi i dy njësive administrative një rurale dhe një qytetare, në përgjithësi në historikun, në mënyrën e administrimit komplikohet gjëja. Për të thjeshtuar dhe procesin dhe për të gjithë ...

Znj. H. Vukaj: (Ndërhyrje pa mikrofon)

Znj. D. Alimemeti: Jo pra, përveç ndarjes së numërit nuk është vazhdimësia, edhe historiku...

Znj. H. Vukaj: (Ndërhyrje, pa mikrofon)

Znj. D. Alimemeti: Jo!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. P. Doçaj: Është dhe për shkak të administrimit të ...

Znj. D. Alimemeti: Është pjesa e administrimit ajo që na detyron që të sjellim këto propozime, për të lehtësuar edhe procesin zgjedhor, por edhe për ne edhe për qytetarët, në fund të ditës. Doni të shohim Tiranën? ZAZ nr. 29, shihni ku është Petrela? ZAZ nr. 29 është e gjitha dhe Petrela është e futur brenda ZAZ nr. 30. Një alternativë, ajo që na bënte më së shumë sens ishte marrja e Petrelës dhe bashkimi me ZAZ nr. 30 duke rregulluar numrat, duke pasur edhe vazhdimësinë territoriale dhe duke eliminuar dhe shtimin e një ZAZ...

Znj. H. Vukaj: Sa zgjedhës ka ZAZ nr. 30?

Znj. D. Alimemeti: ZAZ nr. 30 ka 70...

Znj. P. Doçaj: 69 026 zgjedhës.


Znj. D. Alimemeti: Dhe me shtesën e kësaj shkon diku te 70...

Znj. H. Vukaj: Sa e ka popullsinë ZAZ-ja aktuale pra, ZAZ nr. 29 ku bën pjesë Petrela?

Znj. P. Doçaj: 81 631 zgjedhës.

Znj. D. Alimemeti: Nëse ne bashkojmë Petrelën me ZAZ shkojmë në kuotat e 75 000 votuesve që janë përsëri nën 80 000, pra duke plotësuar limitin prej 80 000 zgjedhësish.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Këtu në hartë duket një facilitet, por gjithë Tirana e di sde ku është Petrela dhe ku është ajo zona tjetër. A ka lidhje Petrela me Krrabën, nuk di.., me çfarë përfshin ajo zona tjetër Bërzhitë, Kerrabë, Farkë, Dajt, Shën Gjergj, Zall Bastar, Zall Herr.

Znj. D. Alimemeti: Shën Gjergji është larg këtu, Petrelë, Bërzhitë janë më këtej.

Znj. H. Vukaj: Ideja është e fenomeneve që do të ndodhin, mund të ndodhin në këtë ZAZ dhe sipas hartës këto selinë e di ku e kanë? E kanë te Shkolla 1 Maji. Jo nuk është për të qeshur kjo gjë. Një gjë të ndodhë aty..., ju duhet ta kishit këtë informacion dhe këtu duhet të vinit të përgatitura. E gjitha kjo pse bëhet? Jo vetëm thjesht për mundësimin e votimit, por kjo bëhet për çdo eventualitet. Një ndodhi aty aty duhet të shkojë ai zyrtari i ngritur për këtë qëllim, të shkojë pas një ore, në këto zona. Kështu që ti duhet ta facilitosh...


Znj. D. Alimemeti: Çdo ZAZ në pjesën e ngritjes së komisioneve, ka të vetat, le të themi.

Znj. H. Vukaj: Po ku e ka zyrën kjo ZAZ, selinë ku e ka?

Znj. D. Alimemeti: Do të caktohet, ende nuk është caktuar.

Znj. H. Vukaj: Pikërisht pra, meqenëse ju i përmbaheni traditës, duhet ta dini!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. I. Nano: Me traditë duhet të jetë, por tani meqenëse e kemi me shtesë, do të ndryshojë.

Znj. H. Vukaj: ZAZ nr. 30 e ka selinë te Shkolla 1 Maji. Mua më lind pyetja, pse nuk ndatë ZAZ nr. 30?

Znj. D. Alimemeti: Nëse do ta bënim do të rritet numri i ZAZ-ve, rriten kostot kjo është logjika. Me ndryshimet që do të bëhen, do të rishihen edhe përcaktimi i selisë së ZAZ-së është në ato gjëra që do të ndryshohen. Ajo që ne kemi propozuar është për të mos shtuar më ZAZ, të cilat përkthehen për ne në kosto. Kjo në kuptim të komisionerëve, paisjeve teknologjike, e të gjithë elementëve që duhen për të ngritur një ZAZ. Tani kjo është çfarë propozojmë ne, një alternativë tjetër mund të ishte dhe ndarja e ...

Znj. H. Vukaj: A krijuat ZAZ të re në Durrës? Këtë koston e llogaritët?


Znj. D. Alimemeti: Po, patjetër, po nuk kishim mundësi për ta bërë këtë punë dhe nuk kishim ku ta zgjidhnim. Kjo ishte alternativa më e mirë e mundshme...

Znj. H. Vukaj: Meqenëse ju përmbajtët koston ekonomike, mund ta kishit ndjekur dhe te ZAZ nr. 21 këtë, përthitheshin nga ZAZ-të e tjera.

Znj. D. Alimemeti: E sqarova, se në pjesën e Durrësit...

Znj. H. Vukaj: Nuk po e bën për mua Daniela, këtë ta keni parasysh dhe të jetë e qartë, po e bëjmë për publikun. Ta kuptojë publiku, ta kuptojnë ata që do të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

përfshihen në proces. Unë ndaj po të drejtoj pyetje për të hequr çfarëdo dyshimi, ose për të lindur dyshime të tjera, apo pikëpyetje të tjera.

Znj. D. Alimemeti: Gjithësesi kjo është ajo çfarë ne kemi parashikuar. Hartat po ju bëjmë një kopje e t'ua vemë menjëherë në dispozicion.

Znj. I. Nano: Pesë minuta pushim sa të marrim hartat dhe të kalojmë në shqyrtimin e aktit.

Rifillon mbledhja

Ora 12:02


Znj. I. Nano: Rifillojmë mbledhjen, hartat i morëm sikundër u kërkuan. Para se të kalojmë në votimin në parim, keni diçka tjetër kolegë, për të pyetur, për të sqaruar me administratën. Në çdo rast do t'ju lutesha, do t'ia përcjell dhe Sekretarit të Përgjithshëm për drejtoritë e tjera. Në rastet kur na duhen ilustrime me harta, me grafikë, e kemi kërkuar dhe herë tjetër, të jemi për mbledhje të plotësuar edhe me këto kërkesa. Keni pyetje të tjera? Po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Një pyetje për ata që na ndjekin. A janë ndjekur të njejtat kritere për të gjitha ZAZ-të? Pra, janë riverifikuar nga ç'kanë qenë? Edhe njëherë?

Znj. D. Alimemeti: Sigurisht, të gjitha ZAZ-të janë verifikuar dhe vetëm këto dy ZAZ kishin nevojë për ndryshime në bazë të asaj çfarë thamë më parë në bazë të numërit të zgjedhësve.

Znj. I. Nano: Dakord! Nga subjektet politike ka diçka? Nga shoqëria civile?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për caktimin e kufijve dhe ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor, për Zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”, po e vendos unë si propozim te titulli këtë. Kalojmë në votim kolegë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Me 5 vota pro ndryshon rendi i ditës!

Znj. H. Vukaj: Të lutem, e nderuar! Edhe diçka tjetër që del si nevojë meqenëse pamë që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka sjellë një akt me vonesë, do të lutesha t’i kërkonit fotografinë e gjendjes në datën kur Kodi Zgjedhor vendos limitet për të sjellë informacion. Pra, data 10 nëntor 2024.

Znj. I. Nano: Në fakt, në funksion të atij akti, duhet fotografia e muajve më pas, pavarësisht e sjell në datë 10, por gjithësesi çfarë do të sillnin ata në rast se do ta sillnin të datën 10 nëntor. Kalojmë në shqyrtimin nen për nen!

Atëherë, Komisioni Rregullator vendosi:

Pika 1. Caktimin e kufijve dhe ngritjen e nëntëdhjetë e tre Zonave të Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kemi diçka kolegë, këtu te pika 1? Kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi... po kishit diçka?

Z. B. Kodra: Afati i ankimimit të korigjohet 5 (pesë) ditë.

Znj. I. Nano: Po! Në çdo rast aktet tona janë 5 (pesë) ditë, pra brenda pesë ditëve nga shpallja e tij. E votojmë këtë, apo e konsiderojmë saktësim? Po!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)


Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi. Po!

Z. M. Çakaj: Edhe diçka! Kush do të ngarkohet për ndjekjen e këtij akti? Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zbatimin e këtij vendimi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. I. Nano: Po! Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zbatimin e këtij vendimi. Pra, të shtohet një pikë 3 dhe pastaj pika 3, bëhet 4.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Votojmë projektvendimin në tërësi. Edhe një herë kolegë, ju lutem dakordësinë tuaj!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Sapo miratuam vendimin “Për caktimin e kufijve dhe ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor, për Zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

Vendimi nr. 15

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

07.12.2024
Ora, 12:07

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore,
për Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**


- **Illirjana** **NANO** **Kryetar**
- **Arens** **ÇELA** **Anëtar**
- **Dritan** **ÇAKA** **Anëtar**
- **Helga** **VUKAJ** **Anëtar**
- **Muharrem** **ÇAKAJ** **Anëtar**
- **Stafi** **KQZ** **J. Josifi, P. Doçaj, D.Alimemeti, B.Kodra**

Parti **Politike:** **PL (K. Kolndreu)**

OJQ: **KRIIK**

Znj. I. Nano: Kalojmë në projektvendimin tjetër, sipas rendit të ditës, “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore, për Zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”. Fillojmë diskutimin në parim! Kolegë, keni diçka!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Z. M. Çakaj: Një propozim kisha unë për administratën, meqenëse pothuajse dihej që data e zgjedhjeve do të ishte 11 maji, edhe mund të na e kishit propozuar me atë datën 11 maj, megjithatë s'ka problem, tani u bë zyrtare (qesh).

Znj. I. Nano: Në parim për projektvendimin, kolegë? Nuk ka gjë! Shoqëria civile, partitë politike? Shkurtimisht dy fjalë për projektaktin, se dy ndryshime të vogla janë.

Znj. P. Doçaj: Projektvendimi është ndarë njësoj si projektvendimi më parë. Është bërë një vlerësim i ligjshmërisë në seksionin e parë dhe në seksionin e dytë është bërë dhe përmbledhja shpjeguese e projektvendimit. Në seksionin e parë kemi përcaktuar kriteret dhe procedurat e caktimit të numërit të mandateve të cilat përcaktohen në nenin 75 dhe 76, afatet e përllogaritjes së mandateve. Për sa i përket pastaj pjesës përmbledhëse dhe shpjeguese të projektaktit, në referim të nenit 76 dhe në referim edhe të informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për numrin e përgjithshëm të shtetasve dhe numrin e shtetasve për çdo qark sipas këtij Regjistri Kombëtar të Gjendjes Civile është kryer edhe përllogaritja. Kjo tabelë, është pjesë përbërëse e projektvendimit, nga ku ka rezultuar se numri total i shtetasve është 4627824, është përpjesëtuar me numrin 140 të mandateve të Kuvendit, ku është përcaktuar dhe numri i cili duhet të jetë mesatar që i takojnë çdo mandati. Së dyti, numri i shtetasve për çdo zonë zgjedhore është pjesëtuar me numrin mesatar të shtetasve që i takojnë çdo mandati. Së treti, çdo zone zgjedhore i është caktuar një numër mandatesh i barabartë me numrin e plotë të përfituar nga ky pjesëtim. Duke u bazuar në materialin dhe në përllogaritjen e kryer në bazë të nenit, nga ana jonë propozohet për shqyrtim dhe miratim nga ana juaj, projektvendimi "Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend. Edhe në këtë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

rast do të duhet që të korrigojmë në projektvendim afatin e ankimit, pasi është 30 ditë dhe duhet të jetë 5 ditë.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Kolegë, kemi diçka?

Z. M. Çakaj: Të njejtën vërejtje që bëra dhe tek akti i parë. Së pari, relacioni do të duhej të ishte firmosur nga të tre...

Znj. P. Doçaj: Të sqaroj vetëm diçka në lidhje me këtë, se nuk munda pak më parë. Te materiali që ju është bashkëlidhur në njoftimin e mbledhjes është i firmosur. Kjo është një kopje e vendosur thjesht për praktikitet sot. Nëse do të shihni emailin, i keni të nënshkruara. Nuk është printuar materiali i skanuër që ju është vendosur në email, por herën tjetër do të printojmë ato. Këto u vendosën thjesht për praktikë për ditën e sotme.

Z. M. Çakaj: Qartë, shumë dakord!

Znj. P. Doçaj: Janë firmosur, se është marrë në konsideratë ajo që ju na keni sugjeruar.

Z. M. Çakaj: Shumë dakord! Në vijim nëse akti, projektakti, rrjedh si bashkëpunim me institucione të tjera, në rastin konkret me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe korespondencën përkatëse, në mënyrë që të jemi të qartë.

Znj. P. Doçaj: Plotësisht e drejtë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. I. Nano: Po, zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Ju na vutë në dispozicion sot koorespondencën me DPGJC.
Funksionon vetëm me email me drejtorinë, jo me shkresa zyrtare?

Znj. I. Nano: Dëshironi ta ndërpresim dhe 5 minuta të tjera mbledhjen për të marrë...

Znj. H. Vukaj: Jo, jo nuk ka rëndësi, vetëm po pyes, me email, apo me shkresë.

Znj. P. Doçaj: Ju keni shkresën që i është çuar fillimisht dhe emaili ku i kemi kërkuar shpjegim...

Znj. H. Vukaj: Ata do të duhet të kthejnë përgjigje me shkresë, apo me email?


Znj. P. Doçaj: Do të duhet të kthejnë edhe me shkresë, edhe me email. Për shpejtësi të gjësë, ne kemi marrë për referencë atë material që na është dërguar nëpërmjet emailit, komunikimit elektronik.

Znj. H. Vukaj: Kam përshtypjen keni një lapsus këtu? Tek emaili i datës 04.11 dhe këta kanë sjellë informacion për 1 dhjetor...

Znj. P. Doçaj: 1 dhjetor është përmbajtja e dokumentacionit.

Znj. H. Vukaj: Emaili është i datës 4.11, i ka dërguar KQZ-së duke përcaktuar se numri i shtetasve është i datës 1 dhjetor 2024.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. P. Doçaj: Numri i shtetasve është i datës 1 dhjetor që duhet të jetë i datës 1 dhjetor, ndërsa përsa i përket... është një lapsus në relacionin e projektvendimit.

Znj. H. Vukaj: Ju rezulton se janë respektuar afatet këtu?

Znj. P. Doçaj: Po, janë respektuar afatet. Ne duhet të kryejmë përllogaritjen, jo më vonë se 15 ditë nga momenti që merret dokumentacioni.

Znj. I. Nano: Keni nevojë për ndonjë material tjetër përpara se të vijojmë me shqyrtimin, me votimin? Faleminderit!

Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore, për Zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!


Kalojmë nen për nen!

Komisioni Rregullator vendosi:

Caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Unë po lexoj lidhjen vetëm me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, për çdo qark Atëherë, Qarku Berat 7 mandate;

Znj. H. Vukaj: Edhe diçka tjetër, e nderuar zonja Nano! Kur të zbardhet dhe të lidhet, kjo duhet të jetë me vulë këtu, me vulë lidhëse, po patjetër!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. I. Nano: Qarku Berat 7 mandate;

Qarku Dibër 5 mandate;

Qarku Durrës 14 mandate;

Qarku Elbasan 14 mandate;

Qarku Fier 16 mandate;

Qarku Gjirokastrë 4 mandate;

Qarku Korçë 10 mandate, ky është qarku që ka një ulje numri nga 11 në 10.

Qarku Kukës 3 mandate;

Qarku Lezhë 7 mandate;

Qarku Shkodër 11 mandate;

Qarku Tiranë 37 mandate dhe Qarku Tiranë ka një mandat më tepër se 2021.


Qarku Vlorë 12 mandate;

Totali 140.

Kush është dakord me pikën 1 kolegë sipas kësaj lidhje?

Znj. H. Vukaj: Jo vetëm një saktësim do të doja. Në parim jam dakord edhe me përmbajtjen që sapo lexuat dakord, sepse ka dalë si pasojë e përlllogaritjes dhe formulës që dikton neni përkatës. Vetëm do të doja një rikompozim të pikës 1, sepse këtë e cakton formula dhe e përcakton dispozita dhe në fakt formulën nuk e aplikojmë ne, por e aplikon administrata dhe e propozon Komisioneri. Atëherë unë do të isha më korrekte dhe do ta gjeja më në rregull fjalinë, në qoftë se do të ishte kompozuar në këtë formë “Për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës siç ju e korigjuat, numri i mandateve të jetë sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi”. Ne nuk caktojmë, ne miratojmë atë çfarë kanë përlllogaritur.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Znj. I. Nano: Rregullatori shqyrton dhe miraton projektet, pra ne miratojmë një projektvendim ...

Znj. H. Vukaj: Miratojmë atë ç'ka na kanë propozuar, caktimin e ka bërë tjetër kush. Ne nuk vendosim kriteret.

Znj. I. Nano: Neni 76, pika 3, në fakt thotë “Në çdo rast numri i mandateve miratohet...”. Pra, miratojmë numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore. “Për caktimin” i ka zbatuar administrata gjatë hartimit të projektvendimit. Atëherë, ne e miratuam në parim, por do të ndërhyjmë dhe te titulli “Për miratimin e numrit të mandateve..” dhe do të ndërhyjmë dhe te pika 1 “Miratimin e numrit të mandateve...”.

E fillojmë me titullin njëherë?

Kush është dakord Kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Te pika 1 do të duhet të votojmë jo thjesht këtë ndryshimin, por kemi votuar përmbajtjen, në total.

Miratimin e numrit të mandateve sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Do të shtoja dhe këtu pikën 3. “Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë dhe në votimin në tërësi të këtij projektvendimi. Edhe njëherë Kolegë, ju lutem dakordësinë tuaj.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)


Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Sapo miratuam edhe vendimin “Për miratimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

Çështje të tjera jashtë rendit të ditës nuk kemi, lidhur me pyetjet që ju drejtuan, thamë brenda 5 ditëve, po u vlerësua që mund të na jepen dhe më herët, në mënyrë që të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 07.12.2024*

caktojmë seancën e radhës për miratimin e projektvendimit që hoqëm sot nga rendi i ditës. Atëherë, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Mirë u pafshim!

Vendimi nr. 14

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

